

Mapecfloor System 34

SISTEM EPOKSID I LYERJES ME BOJE PA SOLUCIONE TRETese PER DYSHEME INDUSTRIALE, KUNDRA PLUHURIT DHE VAJIT

Produkti i perdorur: MAPEFLOOR I 300 SL



PERSHKRIMI

MAPEFLOOR SYSTEM 34 eshte sistem eposidik i lyerjes me boje me efekt te lemuar dhe monokromatik. Me kete sistem eshte e mundur te lyhen dysHEME industriale te cilat perftojne rezistence te larte kimike, papershkueshmeri te larte ndaj vajrave dhe elementeve kimike, rezistence ndaj lavazheve te shpeshta dhe ndaj trafikut te kembesoreve dhe te karrocave te lehta. DysHemet industriale te trajtuara me **MAPEFLOOR 34 SYSTEM** marrin edhe pamje estetike te bukur.

FUSHAT E PERDORIMIT

Aplikimi i **MAPEFLOOR 34 SYSTEM** behet ne dysHEME industriale me trafik te lehte, si: magazina, zona te depozitimit, garazhe, zona te kalimit te kembesoreve dhe karrocave te lehta. Sistemi nuk eshte i pershtatshem per dysHEME ku ka trafik dhe levizje te renduara ose kur lyerja nuk siguron rezistence me te larte mekanike se suporti.

MAPEFLOOR SYSTEM 34 perdoret ne:

- Industrine kimike dhe farmaceutike, ne zonat e magazinimit
- Lokale sterile, laboratore dhe spitale, ne zonat e depozitimit
- Magazina, ne zonat poshte rafteve
- Qendra tregtare, ne zonat e kembesoreve dhe te depozitimit te mallrave
- Industri ushqimore, ne zonat e magazinimit dhe te trafikut te lehte
- Lokale te ftohta, ne zonat e magazinimit

AVANTAZHET

- Efekti i lemuar
- I sigurte per ambientin, sepse nuk permban solucione tretese
- I qendrueshem ndaj kohes, sepse karakterizohet nga rezistence e larte ndaj vjetersimit dhe abrazionit te shkaktuar nga shkeljet dhe lavazhet
- Rezistent ndaj pjeses me te madhe te elementeve kimike, si: acidet baze dhe acidet e holluar, vajrat dhe karburantet
- Siperfaqet e dysHEMEVE marrin pamje te mire estetike dhe karakteristika funksionale
- Siguron raport te perkryer cmim-cilesi



Mapecolor System 34

REZISTENCA KIMIKE

Dyshemete e trajtuara me **MAPEFLOOR SYSTEM 34** rezistojne ndaj:

- Acideve te holluar, si: acid kloridrik, nitrik, fosforik dhe sulfurik. Gjithashtu kane nje rezistence te limituar ndaj acideve organike
- Alkaleve, hidroksidit te natriumit me perqendrim 50% dhe detergjenteve te perdorur per pastrimin e dyshemeve me perqendrim 20-30%
- Sheqerit, edhe ne kontakt te vazhdueshem
- Vajrave minerale dhe karburanteve

NGJYRAT

MAPEFLOOR SYSTEM 34 eshte i disponueshem ne 19 ngjyra.

KONSUMI

Te dhenat e konsumit i referohen aplikimit te sistemit ne temperatura nga +15°C deri ne +25°C dhe ne siperfaqe te lemuara dhe kompakte te betonit. Ne siperfaqe te ashpra dhe ne temperatura me te uleta, konsumi dhe koha e tharjes mund te rriten.

MAPEFLOOR SYSTEM 34 600-700mm

Dora e pare: **MAPEFLOOR I 300SL (A+B+MAPECOLOR PASTE)** - 0.3 kg/m²

Dora e dyte: **MAPEFLOOR I 300 SL (A+B+MAPECOLOR PASTE)** - 0.3 kg/m²

Ne rastet kur **MAPEFLOOR I 300 SL** eshte i ngjyrosur, nuk shtohet komponenti **MAPECOLOR PASTE**.

PERGATITJA E SIPERFAQES

1. Karakteristikat e suportit

Para aplikimit te sistemit **MAPEFLOOR SYSTEM 34** eshte e nevojshme te behet analiza e suportit qe do te trajtohet. Per nje realizim te perkryer te trajtimit, duhet qe:

- Suporti te jete i lemuar
- Mbi suport nuk duhet te kete materiale qe pengojne ngjitjen, si:
 - mbetje cemento
 - pluhur ose pjese te shkeputura
 - produkte te stazhionuara, dyll, parafine, etj
 - njolla vaji ose shtresa rezine
 - mbetje boje ose produkte kimike
- Cdo lloj elementi ndotes qe mund te pengojte ngjitjen duhet hequr para fillimit te punimeve. Ne rastet kur suportit eshte i ndotur nga keto elemente, duhet te merren masat qe te pastrohen siperfaqet me metoda specifike.
- Rezistenca ne zgjatim e suportit duhet te jete me e madhe se 1.5 N/mm²
- Permbajtja maksimale e lageshtires se suportit duhet te jete 2% dhe te jete trajtuar me shtrese me avull. Ne rast se verifikohet qe suportit te mos jete trajtuar si me siper, nuk aplikohet **MAPEFLOOR SYSTEM 34**, sepse sistemi peson shkeputje nga suportit ose krijon pjese te fryra qe ngrihen

Ne rast se permbushen kerkesat e mesiperme, mund te aplikohet **MAPEFLOOR SYSTEM 34** ne dysheme industriale betoni, mbi masete me baze cemento ose te modifikuar me polimere dhe mbi masete me tkurrje te kontrolluar te pergatitur me **MAPECEM** ose **TOPCEM**.



Mapecolor System 34

2. Pergatitja e suportit

Nje siperfaqe e pergatitur mire, eshte elementi kryesor per te siguruar nje aplikim perfekt dhe per te garantuar karakteristikat e **MAPEFLOOR SYSTEM 34**.

Metoda e keshilluar per pergatitjen e suportit eshte menyra e ashpersimit me disk ose me leter zumpara. Pas ashpersimit te siperfaqes se suportit behet pastrimi i siperfaqes nga pluhuri i mbetur. Nuk perdoren metoda qe mund te pershkojne suportin, te cilat e demtojne suportin duke krijuar plasaritje te vogla. Demtimet e suportit, si gropat e vogla dhe plasaritejet, riparohen duke perdorur **EPORIP**, **PRIMER SN** ose **MAPEFLOOR I 300 SL** ne varesi te permasave dhe thellesise se demtimeve. Ne rastet kur eshte e nevojshme perforcimi i suportit, perdoret **PRIMER MF** ose **PRIMER EP**, ne varesi te konsumit. Ne rastet kur suporti ka gropa ose demtime me te medha, suporti riparohet me **MAPEFLOOR EP 19** (llac eposidik me tre komponente) ose me produkte te linjes **MAPEGROUT**.

Mungesa e ketyre kushteve te domosdoshme, sjell cilesine e dobet te punimeve.

3. Verifikimi paraprak i aplikimit

Pasi sigurohet qe suporti te jete pergatitur dhe te permbushe karakteristikat e lartpermendura, verifikohet qe temperatura e ambientit te jete me madhe se +8 °C dhe temperatura e suportit mbi piken e kondensimit te jete te pakten +3 °C.

4. Pergatitja dhe aplikimi i produkteve

Pergatitja dhe aplikimi i produkteve behet sipas pershkrimeve ne skedat teknike te produkteve.

Aplikimi me trashesi 600-700 mm

• Dora e pare (**MAPEFLOOR I 300 SL**)

Hidhet komponenti B (2kg) ne komponentin A (6kg), shtohet ngjyruesi **MAPECOLOR PASTE** (per cdo njesi **MAPEFLOOR I 300 SL** shtohet 0.7 kg **MAPECOLOR PASTE**) dhe perzihen me trapano me numer te vogel xhirosh derisa te perftohet nje perzierje homogjene. Perzierja aplikohet ne menyre uniforme dhe te vazhdueshme me ane te nje ruli, ne menyre qe siperfaqja e lyer te mos kete defekte.

• Dora e dyte (**MAPEFLOOR I 300 SL**)

Hidhet komponenti B (2kg) ne komponentin A (6kg), shtohet ngjyruesi **MAPECOLOR PASTE** (per cdo njesi **MAPEFLOOR I 300 SL** shtohet 0.7 kg **MAPECOLOR PASTE**) dhe perzihen me trapano me numer te vogel xhirosh derisa te perftohet nje perzierje homogjene. Perzierja aplikohet ne menyre uniforme dhe te vazhdueshme me ane te nje ruli, ne menyre qe siperfaqja e lyer te mos kete defekte.

Ne rast se deshirohet nje siperfaqe me pak e rreshqitshme, ne perzierjen e dores se dyte shtohet 5-10 % **MAPEFLOOR FILLER**.

5. Tharja dhe kalueshmeria

Siperfaqet e trajtuara me **MAPEFLOOR SYSTEM 34**, ne nje temperature +25 °C, mund te shkelen me kembe dhe kalohen pas vetem 16 oresh. Per kalimin e karrocave te lehta duhet te pritet nje dite nga aplikimi i dores se dyte. Ne temperatura me te uleta, kohet e tharjes dhe te kalueshmerise rriten me teper.

Mapecfloor System 34

PASTRIMI DHE MIREMBAJTJA

Pastrimi dhe mirembajtja e rregullt shton jetegjatesine e siperfaqeve te trajtuara me **MAPEFLOOR SYSTEM 34**, permireson aspektin estetik dhe redukton akumulimin e papastertive. Zakonisht siperfaqet e trajtuara me **MAPEFLOOR SYSTEM 34** lahene lehtesisht me detergjente alkaline te holluar me uje. Gjithashtu ka edhe detergjente te pershtatshem per pastrimin e dysHEMEVE me rezine.

SHENIME

Te dhenat e sigurise jepen ne skedat e sigurise te cdo produkti qe perben sistemin **MAPEFLOOR SYSTEM 34**. Megjithate, eshte e keshillueshme, qe perdoruesit te perdorin doreza dhe syze mbrojtese gjate perzierjes dhe aplikimit te produkteve.

TE DHENAT TEKNIKE (pas 7 ditesh, ne temperature +23°C)

Ngjitja (DIN ISO 4624)	> 1.5 N/mm ²
Rezistenca ndaj abrazionit (TABER CS 17)	98 mg
Rezistenca ndaj temperatures se ajrit	-20°C - +40°C
Aspekti i jashtem	i shkelqyeshem